



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Assambly of Kaçanik

01Nr. 08-320/01-18621/19
Kaçanik, 28.06.2019

Në bazë të nenit 12. 2(d) lidhur me neni 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 04 Qershor 2008), të nenit 6.2 të Statutit të Komunës të datës 25.09.2008, Konkluzioneve nga takimi i Kryesuesit të KK me mekanizmat relevantë për mbrojtjen e pyjeve dhe nevojës për vendosjen e automjeteve dhe masës drunore të konfiskuara, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 28 Qershor 2019, mori këtë:

V E N D I M

PËR QËNDRIMIN E MASËS DRUSORE DHE AUTOMJETEVE TË KONFISKUARA NË AUTOPARKUN E SHIL-së

1. Me këtë vendim, vendoset që automjetet dhe masa drunore të konfiskuara, të cilat vendosen në Autoparkun e Shoqatës së Invalidëve të Luftës (SH.I.L.-ës), për qëndrim deri në marrje të Vendimit të Gjykatës për sekuestrimin e automjeteve, të qëndrojnë pa pagesë në autoparkun e SHIL-së, ndërsa shoqatës (SHIL), kompensimi t'i bëhet me masë drunore të sekuestruara.
2. Përgjegjësia për ruajtjen e automjetit dhe masës drunore të deponuar në oborrin e autoparkut të SH.I.L.-së, bien mbi Shoqatën Invalidëve të Luftës së UÇK-së dega në Kaçanik.
3. Për ruajtjen e automjeteve të sekuestruara dhe masës drunore që deponohen në oborrin e Autoparkut të SHIL, për arsye të mungesës së lokacionit, ndarja e masës drusore e sekuestruara ndahet në proporcion të barabartë në mes të Komunës dhe SHIL dhe atë: 50% i takojnë Komunës dhe 50% i takojnë SHIL.
4. Detajet tjera të cilat nuk janë specifikuar në këtë Vendim, do të rregullohen më Marrëveshje në mes të Kryetarit të Komunës dhe SHIL-së e UÇK-së, dega në Kaçanik.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltarisë dhe SHIL-së.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Bujqësi Zhvillim Rural dhe Pylltari- përmes kësaj drejtorie njoftohet SHIL dhe mekanizma tjerë relevantë dhe Arkivi.


A r s y e t i m

Kuvendi i Komunës Kaçanik, duke u thirrur në arsyetimin e Drejtorisë së DBZHRP-së të theksuar në Propozim Vendim për gjendjen e krijuar në pyjet e Komunës së Kaçanikut, e cila drejtori në konsultim me institucionet Gjyqësore dhe Prokurorisë lidhur me gjendjen dhe masat që duhet ndërmarr për mbrojtjen e pyjeve nga prerja e tyre, se në afatin kohor brenda pesë (5) ditësh duhet të pasoj Kërkesa për sekuestrimin e automjeteve që hasen në pyll duke dëmtuar pyjet publike nga kryerësit e kësaj vepre penale, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Assambly of Kaçanik

Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural
dhe Pylltari

08 Nr. 320/01-18621/19
Kaçanik, 25.06.2019

Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari në bazë të nenit 84 të Statutit të Komunës së Kaçanikut:

PROPOZON

Që Kuvendi i Komunës në mbledhjen e radhës më datë 28.06.2019 të merr:

V E N D I M

1

Që automjetet dhe masa drurore të konfiskuara, të cilat vendosen në Autoparkun e Shoqatës së Invalidëve të Luftës (SH.I.L-ës), për qëndrim deri në marrje të Vendimit të Gjykatës për sekuestrimin e automjeteve që qëndrojnë pa pagesë në autoparkun e SH.I.L-së, ndërsa shoqatës kompenzimi ti bëhet me masë drurore të sekuestruara.

2

Për automjetet dhe masën drurore të sekuestruara të cilat vendosen në autoparkun e SH.I.L-së, përgjegjësia për ruajtjen e automjetit dhe masës drurore të deponuar në oborrin e autoparkut të SH.I.L-së bie Shoqatë së Invalidëve të Luftës.

3

Për ruajtjen e automjeteve dhe masës drurore të sekuestruara, SHIL-ës kërkon ndryshim për kompenzimin, me ndarje të masës drurore të sekuestruar, e cila me kontratën e më hershme nr.28/2010 të datës 10.09.2010, e lidhur me Drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë (DBZHRP-së) dhe kryetarin e SHIL-së, ka qenë e specifikuar ndarja e masës drurore e konfiskuar, në proporcion 60% Komunës, 40% SHIL-ës.

4

Andaj DBZHRP-së duke marrë për bazë gjendjen e krijuar, lidhur me qëndrimin e automjeteve dhe masës drurore që deponohet në oborrin e autoparkut të SHIL-së, për arsye të mungesës së loacionit për deponim të masës drurore dhe ruajtjen e automjeteve të sekuestruara, propozon

që Kuvendi në mbledhjen e radhës të merr Vendim që ndarja e masës drurore e sekuestruar të ndahet në proporcion 50% Komuna , 50% SHIL-së.

5

Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltarisë dhe SHIL-së

6

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Bujqësi Zhvillim Rural dhe Pylltari, SHIL-së si dhe Akiva e Komunës.

A r s y e t i m

Drejtoria e DBZHRP-së duke marrë për bazë gjendjen e krijuar në pyjet tona, me sygjërimet e marra nga, qytetarët, institucionet Gjyqësore dhe Prokuroriale, lidhur me gjendjen dhe masat që duhet ndërmarr për mbrojtjen e pyjeve nga prerja e tyre, na inkurajuan që DBZHRP-ëja afatin kohor brenda pesë (5) ditësh të bëjë kërkesën për sekuestrimin e automjetëve që hasen në pyll duke dëmtuar pyjet publike nga kryesit e kwsaj vepre penale.

DREJTORI I DBZHRP-së
Fatmir Loku





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

DATE/A:	24.06.2019
REFERENC-Ë:	08-320/01-18621/19
PËR/ZA/TO:	z.Besim Ilazi, Kryetar i Komunës
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Fatmir Loku, Drejtor i DBZHRP-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë

Drejtoria e BZHRP-së duke marrë parasysh problemin me të cilin po ballafaqohet çdo ditë, lidhur me konfiskimin e automjeteve që hasen në pyll apo duke transportuar masë drusore në mënyrë ilegale, vendosjen e tyre dhe qëndrimin deri në marrjen e Vendimit për sekuestrim të automjeteve nga ana e prokurorisë së shtetit.

Drejtoria e BZHRP-kërkesën e adreson që Kuvendi Komunal, në mbledhjen e radhës të merr Vendim për lidhjen e marveshjes së re me Shoqatën e Invalidëve të Luftës (SHIL), për qëndrimin e automjeteve të konfiskuara pa pagesë në autoparkun e SHIL-së, deri në marrjen e vendimit të Gjykatës për sekuestrimin e automjetit, pasi që në takimin e mbajtur më datën 18.06.2019 të thirrur nga Kryesusi i Kuvendit z.Kemajl Murseli, për të diskutuar lidhur me gjendjen e pyjeve dhe masat që duhet ndërmarr në mbrojtjen e pyjeve publike e në veqanti pjesën e Parkut Kombëtar "Sharri". Në takimin e thirrur prezentuan: Kryetari i Komunës z. Besim Ilazi, Kryeprokurori i Gjykatës në Ferizaj, z.Shukri Jashari, z.Burim Qaka, gjyqtarë në

Gjykatën Themelore, dega në Kaçanik, Komandanti Stacionit Policor z. Halim Shehu, kryetarët e grupeve parlamentare si dhe administratorët e fshatërave. Me sygjerimet e dhëna në takimin e mbajtur nga kryeprokurori, në fund të takimit jemi dakorduar që DBZHRP-së, në afatin prej 5 ditësh të paraqes kërkesë për sekuistrim të automjeteve që konfiskohen, në të kundërtën sipas tij mbajtja e automjeteve është antiligjore.

Andaj Kërkojmë në mbledhjen e radhës së Kuvendit komunal, kërkesa e drejtorisë, të futet në rend dite për shqyrtim dhe marrje të vendimit për lidhjen e një marveshje të re, me Shoqatën e Invalidë të Luftëslidhur me qëndrimin e automjeteve pa pagesë në autoparkun e SHIL- së apo në gjetjen e ndonjë lokacioni tjetër.

Marveshja e që kemi deri më tani me SHIL-së ka qenë, që masa drusore e konfiskuar të ndahet në proporcion 60% Komuna, 40% SHIL-së, mirpo shoqata për automjetet e konfiskuara ka ngarkuar pronarët e automjeteve, për qëndrim 24 orësh të automjetit me nga 10 €.

Shoqata e Invalidëve të Luftës ka shprehur gadishmëri që për qëndrimin e automjeteve pa pagesë në autoparkun e SHIL-së dhe masës drusore të konfiskuar, të bëhet ndarja e masës drusore 50 % Komunës, 50% SHIL-së.

Kuvendi Komunal
Kaçanik

KONTRATË

E lidhur në mes:

1. Kuvendit Komunal të Kaçanikut, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari (D.B.ZH.R.P).
2. Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së dega në Kaçanik, (Sh. I. L. të UÇK-së).

1.

Drutë të cilat do të konfiskohen nga organet kompetente (Inspektionet Komunale, Policia e Kosovës, Punëtorët e Pylltarisë), do të dërgohen në parkingun e Sh. I. L. të UÇK-së, dega në Kaçanik.

2.

Në rast se mjete i cili është duke bërë ngarkimin apo transportimin ilegal të druve, është i lëvizshëm, (traktori, kamioni etj.), atëherë me urdhër të organeve kompetente nga neni 1, pala së cilës i'u konfiskohen drutë është e obliguar që të bën bartjen dhe shkarkimin e druve në parkingun e Sh. I. L. të UÇK-së, i cili gjendet në rrugën "Vëllezërit Çaka" në Kaçanik.

3.

Në rast se mjete i cili është i ngarkuar me dru është i palëvizshëm, atëherë Sh. I. L. të UÇK-së është e obliguar që t'a bëjë transportin e druve deri në parkingun e Sh. I. L. të UÇK-së, në Kaçanik.

4.

Ndarja e druve të grumbulluara do të jetë në proporcionin:
40% të Sh. I. L. të UÇK-së dega në Kaçanik,
60% të Kuvendit Komunal të Kaçanikut.

5.

Me këtë kontratë njoftohen: Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, në Kaçanik, Policia e Kosovës, Kryetari i Sh. I. L. të UÇK-së, dhe Arkiva e Sh. I. L. të UÇK-së.

6.

Kontrata vlen deri në marrjen e ndonjë vendimi tjetër nga ana e Kuvendit Komunal dhe Sh. I. L. të UÇK-së dega në Kaçanik.

Drejtori i DBZHRP
z. Nuhi Provolhu

Datë: 10.09.2010
Kaçanik



Kryetari i Sh. I. L. të UÇK-së
Elfiar Bunjaku

